



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.179/3 Prot

Tiranë, më 21.02.2023

VENDIM

Nr.04, datë 21.02.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2060 Prot., datë 07.12.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës për informacion të protokolluar pranë Autoritetit Publik me nr. 4058 Prot., datë 27.10.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni si vijon:

- 1- *Sa gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar në periudhën Janar 2021 – Tetor 2022, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, “KPK”) apo vendim të formës së prerë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit? Cilat janë pozicionet që ata kanë mbajtur në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë?*
- 2- *Sa gjyqtarë dhe prokurorë janë dorëhequr brenda të njëjtës periudhe? Cilat janë pozicionet që ata kanë mbajtur në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë?*
- 3- *A ka pasur raste kur organi që Ju drejtoni apo anëtarë të tij kanë referuar apo kallëzuar pranë Prokurorisë së Posaçme apo ato të Juridiksionit të Përgjithshëm, fakte që janë zbuluar gjatë procesit të rivlerësimit që përbëjnë vepra penale që*

ndiqen kryeisht, në zbatim të nenit 281, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale? Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon të njihet me kopje të dokumentacionit, me anë të të cilit është bërë ky referim.

- 4- A ka patur raste kur prokuroritë në fjalë janë vendosur në lëvizje me inisiativë (ex officio), në kushtet kur procesi i vettingut ka karakter publik? Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon të njihet me një kopje të dokumentacionit (nëse dispononi) ku ndërmerret nisma nga prokuroritë në fjalë, në korrespondencën që mund të kenë patur me ju, për këtë periudhë?*
- 5- Në kuadër të pikave 3 dhe 4 si më sipër, a ju është komunikuar nga këto prokurori nevoja për dokumentacion shtesë lidhur me këto subjekte apo çdo kërkesë apo komunikim tjetër zyrtar prej tyre në funksion të mbarëvajtjes së hetimeve (Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon të njihet me kopjen e dokumentacionit nëse dispononi)?*

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 4058/1 Prot., datë 11.11.2022, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion, duke cituar se: “...Për periudhën Janar 2021 – Tetor 2022, trupat gjykuese të Komisionit kanë dhënë 99 vendime për shkarkimin nga detyra për 52 gjyqtarë, 45 prokurorë dhe 2 inspektorë, nga të cilët 1 Inspektor i komanduar në ILD dhe 1 Inspektor në KLGJ (Tabela 1, bashkëlidhur).

Lidhur me pyetjen e dytë, për të njëjtën periudhë janë dorëhequr sipas nenit G të Aneksit Kushtetues dhe u është ndërprerë më vendim të KPK-së, procesi i rivlerësimit kalimtar, 41 subjekteve të rivlerësimit gjithësej, nga të cilët, 24 janë gjyqtarë, 10 prokurorë, 1 ish – prokuror, 5 ndihmës ligjorë dhe 1 këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese (Tabela 2, bashkëlidhur).

Sa i takon pyetjes së tretë, mbi rastet e referuara apo kallëzuar nga KPK në organet e posaçme të hetimit, Komisioni informon se ka referuar gjithësej 13 raste në SPAK, bazuar në rezultatet e hetimit. Sa i takon kërkesës për vënien në dispozicion të dokumentacionit, ju informojmë se nuk mund t’u përmbushim atë, pasi bazuar në nenin 17, pika 2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kjo e drejtë është e kufizuar.

Ndërsa, lidhur me pyetjen e katërt, ju informojmë se janë 19 raste, për të cilat SPAK ka kërkuar ex-officio dosjet e subjekteve. Dokumentacioni apo korrespondenca me këtë strukturë nuk mund t’ju vihet në dispozicion pasi përbën kufizim sipas ligjit për të drejtën e informimit.

Sa i takon pyetjes së fundit sqarojmë se Komisioni është treguar çdo herë që ka lindur nevoja bashkëpunues me organet e hetimit. Komunikimet mes KPK-së dhe këtyre organeve lidhur me këto çështje, nuk mund të ndahen me palë të treta jashtë këtij procesi.”

Në vijim, pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se: “...ndodhet përpara refuzimit të dhënies së dokumentacionit përkatës të kërkuar në pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion me arsyetimin nga KPK-ja, se kjo e drejtë është e kufizuar sipas parashikimit të nenit 17, pika 2/b e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky veprim i Autoritetit Publik përbën një interpretim të gabuar të ligjit dhe rrjedhimisht kufizim të aksesit të kërkuarit në informacion publik, për arsyet si më poshtë vijnë:

Së pari veprimtaria e KPK-së parashikohet nga Kushtetuta dhe rregullohet nga ligji nr.84/2016 dhe një ndër qëllimet e së cilit është edhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë. Kërkesa për informacion për të vendosur në dispozicion informacion publik ka qëllim të njëjtë me atë të ligjit, krahas karakterit publik të informacionit që kërkohet.

Së dyti, mendojmë se nuk jemi para dispozitës së referuar nga Autoriteti Publik, konkretisht neni 17 pika 2/b e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për refuzimin e dhënies së informacionit pasi referuar këtij neni e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë të interesave për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.

Kujtojmë se referuar ligjit nr. 84/2016 KPK, zhvillon proces administrativ ndaj subjekteve të rivlerësimit, ndërkohë, arsyeja e treguar nga KPK për të refuzuar dhënien e dokumentacionit të kërkuar nga KSHH në pikat 3, 4 dhe 5 arsyetohet me “parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale”. Ky arsyetim bie jashtë tagrit të kompetencave të KPK-së, pasi nuk ka kompetenca për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.

Referuar nenit 20 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim, “KPrP”) është prokurori ai që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Ndërkohë edhe detyrimi për të ruajtur sekretin hetimor, i cili pretendohet nga KPK është një moment juridiko penal, mbi të cilin, sipas nenit 279 të KPrP disponon prokurori i çështjes dhe jo institucione të tjera, përfshirë KPK.

Së treti e drejta e informimit referuar nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kufizohet vetëm në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të parashikuara nga ligji. Ndërkohë sipas pikës 6 të po këtij neni, nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Në rastin e refuzimit të KPK-së për pikën 4 dhe 5 të kërkesës për informacion, nuk jepet asnjë arsyetim i bazuar në raport me një bazë konkrete ligjore për të treguar se ku bazohet refuzimi i informacionit.

Gjithashtu, referuar nenit 4 pika 7 të ligjit nr. 84/2016 e drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Për të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit. Në rastin konkret nuk ndodhemi përballë kriterëve të tilla ligjore, të cilat nuk pretendohen nga KPK në arsyetimin e saj për të mos dhënë informacionin e kërkuar nga KSHH”.

Në këto kushte, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, duke kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës, të kërkuar në pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim, “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 2060/1 prot., datë 09.12.2022, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe argumentin përkatës në rast të kufizimit të të drejtës për informim, bazuar në nenin 17 të LDI ose legjislacionin e posaçëm.

Në vijim Autoriteti Publik, me shkresën nr. 4920/1 Prot., datë 16.12.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2060/2 Prot., datë 19.12.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*...Lidhur me pyetjet 3 dhe 4 të kërkesës për informacion, sa i përket dokumentacionit me anë të së cilit është bërë referimi...Komisioni ka vlerësuar mos e ndaj atë me publikun apo palë të tjera jashtë këtij procesi, pasi ekziston një interes më i lartë se ai, për dhëniën e informacionit/dokumentacionit një subjekti kërkues, që:*

- a) *Kjo mund të cenojë parandalimin, hetmin dhe ndjekjen e veprave penale nga këto organe;*
- b) *Mund të cenojë po ashtu, të dhënat personale të subjekteve apo të personave të tjerë të përfshirë në materialet hetimore.*

Për këto arsye dhe në frymën e Kushtetutës dhe të ligjit, Komisioni me të drejtë ka mbajtur në konsideratë dispozitën kufizuese të nenit 17, pika 2/b të LDI.

Megjithë parashikimet e nenit 17 të Kushtetutës dhe kufizimet e Nenit “A” të Aneksit Kushtetues, institucioni ynë nuk mund të shkelë të drejtat dhe as detyrimet ligjore, që të mbajë një qëndrim proporcional dhe të drejtë ligjor, duke garantuar nga njëra anë të drejtat e palës së interesuar për informacion dhe nga ana tjetër moscenimin e punës së organeve të hetimit penal, por edhe të drejtat themelore të njeriut/personave që përmenden në materialet e referuara. Edhe pse subjekti kërkues KSHH, citon nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, sqarojmë se ky nen është zbatuar dhe po zbatohet me shumë korrektësi nga KPK në procesin kushtetues të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Në zbatim të detyrimeve kushtetuese ligjore, Komisioni publikon çdo vendim të tij të anonimizuar, duke përmbushur kështu, me dhe pa kërkesë, informimin e publikut dhe të çdo të interesuari për këtë proces. Kjo në zbatim edhe të nenit 4, pika 5 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër dhënia e informacionit në mënyrë të kufizuar vetëm në statistika (për pikat 3 dhe 4) nuk mund të cilësohet nga KSHH si refuzim, por duhet parë në dritën e dispozitave ligjore të sipërpërmendura. Lidhur me pretendimet e KSHH për pyetjen 5, Komisioni i qëndron mendimit se komunikimet ndërinstitutionale që kanë në objekt referimin e rasteve apo dhënien e dokumenteve, me dhe pa kërkesë nga organet e hetimit, nuk mund të bëhen publike apo t'i vihen në dispozicion palëve të treta jashtë procesit penal.”

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri, bazuar në nenet 53, 91 dhe 92 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 2060/3 Prot., datë 30.12.2022 “Për zgjatjen e afatit të procedurës administrative”, vendosi shtyrjen e tij.

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 12.01.2023, me prezencën e përfaqësuesëve të ankuesit dhe Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ankuesit rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës, të kërkuar për pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion, me pretendimin se, vetë Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur në dispozicion një informacion mbi hetimet ndaj subjekteve të rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e Zyrës së Komisionerit, u pyetën përfaqësuesit e Autoritetit Publik nëse dokumentacioni i kërkuar është i klasifikuar sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, apo sipas legjislacionit të posaçëm penal.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik u shprehën se nuk e kishin konsultuar fizikisht dokumentacionin e kërkuar. Në këto kushte, kërkuan kohë për t’u shprehur për këtë çështje si dhe për të vlerësuar pretendimin e ngritur nga ankuesi në lidhje me vënien në dispozicion të informacionit nga SPAK.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 23/1 Prot., datë 17.01.2023, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, duke cituar ndër të tjera se: “...Informacioni që përmban referimet e rasteve në SPAK nuk ka klasifikim sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, por Komisioni vijon t’i qëndrojë mendimit dhe vlerësimit se: Përhapja dhe vënia në dispozicion e dokumentacionit për rastet e referuara në SPAK, palëve të treta, jashtë procesit të rivlerësimit apo atij penal, pavarësisht qëllimit të studimit, cenon hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, akte këto të cilat i disponon dhe mund t’i disponojë vetëm SPAK si organ hetimi.

Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 17, pika 2 e LDI, rastet e përjashtimit nga kufizimi i së drejtës (ref. Nënparagrafëve të shkronjave nga “a” në “ë”). Në këtë dispozitë ligjore nuk bën përjashtim nga kufizimi nënparagrafi “b”, konkretisht: “...b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale”;

...Komisioni i konsideron këto raste të referuara nga ana e tij në SPAK ende në proces, sa kohë që dokumenti i prodhuar gjatë hetimit nga KPK i shërben një hetimi tjetër, atij

me natyrë penale të posaçme që ushtrohet nga një strukturë tjetër kompetente dhe e pavarur kushtetuese. Për rrjedhojë, vlerësojmë se tashmë është SPAK autoriteti kompetent dhe që vendos dhënien ose jo të informacionit/dokumentacionit, përzgjedhjen e tij dhe sasinë e informacionit, pavarësisht se dokumentacioni/materialet e referuara janë prodhuar nga KPK...”

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, nëpërmjet e-mail-it datë 18.01.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 179/1 Prot., datë 18.01.2023, ka vijuar me ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik të vendosë në dispozicion dokumentacionin përkatës lidhur me pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion, të protokolluar pranë Autoritetit Publik me nr. 4058 Prot., datë 27.10.2022.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Referuar vetë rëndësisë së procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, qëllimi i të cilit është rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës dhe pavarësisë së këtij sistemi, legjislatori jo pa qëllim ka parashikuar, në pikën 1 të nenit A, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, se: *“Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.”*

Neni 17 i Kushtetutës parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë se: *“... mund të vendosen me ligj për një interes publik, ose mbrojtjen e të drejtave të tjerëve”*.

Gjithashtu, qëllimi i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës.”.

Nga sa më sipër, në analizë të të gjithë kuadrit ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit në sistemin e drejtësisë, reflektohet qartë mbizotërimi i interesit publik në raport me interesat e subjekteve të rivlerësimit. Ky qëndrim është mbajtur gjithashtu dhe nga Gjykata Kushtetuese e cila në vendimin e saj nr. 02, datë 18.01.2017, me objekt shqyrtimin e ligjit 84/2016, ka çmuar se: “Gjykata vëren se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë”.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të administruara dhe cituar më sipër, rezulton se Autoriteti Publik, ka përmbushur detyrimin duke vendosur në dispozicion informacionin lidhur me pikat 1 dhe 2 të kërkesës për informacion datë 27.10.2022, për të cilën nga ana e ankuesit nuk është depozituar ankim.

Ndërkohë, për sa i përket pikave 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion datë 27.10.2022 Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion një informacion statistikor lidhur me rastet e referuara/kallëzuara në SPAK, por nuk ka vendosur në dispozicion kopje të dokumentacionit, me anë të të cilit është bërë referimi apo korrespondenca e shkëmbyer me SPAK, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesën për informacion, për të cilën është depozituar edhe ankimi.

Në qëndrimin e Autoritetit Publik Komisioneri konstaton se, kufizimi i informacionit është bërë në referim të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 17 të LDI, pa marrë parasysh pikën 6 të këtij neni në të cilën citohet se: “6. Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkesit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton se Autoriteti Publik të ketë bërë një vlerësim të dokumentacionit të kërkuar, por është mjaftuar vetëm me vënien në dispozicion të informacionit statistikor, qëndrim ky në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar. Komisioneri, thekson se, Autoriteti Publik bazuar në nenin 17 të LDI, ka detyrimin që përveçse të garantojë të drejtën e informimit, të mbrojë të dhënat personale, sekretin tregtar etj. Por, në çdo rast, ekzistenca e një procedimi penal, nuk përbën *a priori*, pengesë për dhënien e informacionit.

Në rastin konkret, objekt ankese, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se për këto raste Autoriteti Publik ka depozituar kallëzim në SPAK, ai në asnjë moment gjatë hetimit administrativ, nuk provoi se publikimi i këtij informacioni do të cenonte hetimin penal të nisur nga ky i fundit.

Komisioneri, për nevoja të hetimit administrativ, me shkresën nr. 179 Prot., datë 18.01.2023, kërkoi nga SPAK, qëndrimin nëse informacioni i kërkuar i nënshtrohet apo jo sekretit hetimor të pretenduar nga Autoriteti Publik, si rast kufizimi në përputhje me shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 17 të LDI.

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, SPAK me shkresën nr. 967/1 Prot., datë 07.02.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 179/2 Prot., datë 08.02.2023, ka sqaruar se: “...Komiteti Shqiptar i Helsinkit me shkresën nr. 561 Prot., datë 31.10.2022, ka kërkuar nga Prokuroria e Posaçme informacion dhe statistika mbi hetimet penale ndaj subjekteve të rivlerësimit. Në lidhje me kërkesën e paraqitur i kemi kthyer përgjigje me shkresën tonë nr. 9709/1 Prot., datë 02.12.2022”. Ndërkohë, kjo strukturë nuk ka cituar asnjë pengesë ligjore për mosbërjen publike të informacionit të kërkuar, objekt ankese.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur organi hetimor nuk është shprehur për sekret hetimor të rastit konkret dhe Autoriteti Publik pranon se e disponon dokumentacionin, objekt ankese, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: “*Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit dokumentacionin e kërkuar në formatin e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Personat përgjegjës për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar duhet të tregojnë kujdes në fshirjen e të dhënave të personave të tjerë të cilët përmenden në mënyrë sporadike në këto dokumente. Në këto raste identiteti i tyre, por edhe të dhëna të tjera të cilat mund ti identifikojnë ato në mënyrë indirekte duhet të bëhet në formë të anonimizuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: “*Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...*”.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 2060 Prot., datë 07.12.2022, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës lidhur me pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion të protokolluar pranë Autoritetit Publik me nr. 4058 Prot., datë 27.10.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 28.02.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 21.02.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi